PUBLIC
Date original: 08/10/2021 17:12:00
Date translation: 13/10/2021 14:22:00

KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: **KSC-BC-2020-06**

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: **Gjykatësi i Procedurës Paraprake**

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 8 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: **Publik**

Urdhër Drejtuar Policisë së Kosovës për Dorëzim Informacioni

me Shtojcë konfidenciale

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkateswari Alagendra

T'i dorëzohet
Policisë së Kosovës

PUBLIC
Date original: 08/10/2021 17:12:00
Date translation: 13/10/2021 14:22:00

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,[1] në pajtim me nenet 39(13) dhe 53(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (″Ligji), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 dhe 5 nëntor 2020 (sipas rastit),[2] pas konfirmimit të aktakuzës,[3] Kadri Veseli ("z. Veseli"), Rexhep Selimi ("z. Selimi") dhe Jakup Krasniqi ("z. Krasniqi") (bashkërisht, "të akuzuarit") u arrestuan në bazë të një vendimi dhe të fletarrestimeve të lëshuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.[4]

2. Më 22 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzoi kërkesat për lirim të përkohshëm të parashtruara në emër të të akuzuarve.[5]

---

[1] KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

[2] KSC-BC-2020-06, F00044, Administratorja, *Njoftim për Arrestimin e Jakup Krasniqit në pajtim me Rregullën 55(4)*, 4 nëntor 2020, publik; F00049, Administratorja, *Njoftim për Arrestimin e Rexhep Selimit në Pajtim me Rregullën 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik; F00050, Administratorja, *Njoftim për Arrestimin e Kadri Veselit në Pajtim me Rregullën 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik.

[3] KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u lëshuan përkatësisht më 19 nëntor 2020 dhe 30 nëntor 2020, F00026/CONF/RED dhe F00026/RED); F00045/A01, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë*, 4 nëntor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni më i redaktuar publik u lëshuan po atë ditë, F00045/A02 dhe F00045/A03).

[4] KSC-BC-2020-06, F00027, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi*, 26 tetor 2020, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua më 26 nëntor 2020, F00027/RED); F00027/A03, *Fletarrestimi për Kadri Veselin*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00027/A05, *Fletarrestimi për Rexhep Selimin*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00027/A07/COR, *Versioni i Korrigjuar i Fletarrestimit për Jakup Krasniqin*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (versionet e redaktuara publike u lëshuan më 5 nëntor 2020, F00027/A03/RED, F00027/A05/RED dhe F00027/A07/COR/RED).

[5] KSC-BC-2020-06, F00178, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, publik; F00179, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Rexhep Selimit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua më 26 janar 2021, F00179/RED); F00180, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Jakup Krasniqit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua më 26 janar 2021, F00180/RED).

PUBLIC
Date original: 08/10/2021 17:12:00
Date translation: 13/10/2021 14:22:00

3. Më 25 qershor 2021 dhe 2 korrik 2021 (sipas rastit), Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e mbajtjes në paraburgim të të akuzuarve.[6]

4. Më 1 tetor 2021, Gjykata e Apelit nxori vendimet mbi apelet e paraqitura nga të akuzuarit kundër vendimeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake të datave 25 qershor 2021 dhe 2 korrik 2021, me të cilat ai urdhëronte vazhdimin e mbajtjes së tyre në paraburgim.[7] Ndër të tjera, Gjykata e Apelit ia ktheu këto vendime Gjykatësit të Procedurës Paraprake për shqyrtim të mëtejshëm për të vlerësuar nëse Policia e Kosovës mund të sigurojë zbatimin efektiv të kushteve të propozuara nga të akuzuarit, ose çfarëdo kushti tjetër të identifikuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që është i nevojshëm për të zvogëluar rreziqet e identifikuara.[8]

5. Më 7 tetor 2021, Mbrojtja e z. Veseli parashtroi kërkesë që Policisë së Kosovës t'i jepej një urdhër i përshpejtuar.[9]

---

[6] KSC-BC-2020-06, F00371, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Jakup Krasniqit,* 25 qershor 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua më 30 qershor 2021, F00371/RED); F00372, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Rexhep Selimit,* 25 qershor 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua më 30 qershor 2021, F00372/RED); F00380, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Kadri Veselit,* 2 korrik 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, F00380/RED).

[7] KSC-BC-2020-06, IA006/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit (*"Vendimi i Apelit të Krasniqit"*),* 1 tetor 2021, konfidencial; IA007/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit* ("Vendimi i Apelit të Selimit"), 1 tetor 2021, konfidencial; IA008/F00004, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit* ("Vendimi i Apelit të Veselit"), 1 tetor 2021, konfidencial (versionet e redaktuara publike u lëshuan po atë ditë, IA006/F00005/RED, IA007/F00005/RED, IA008/F00004/RED).

[8] Vendimi i Apelit të Krasniqit, para. 56-58; Vendimi i Apelit të Selimit, para. 56-58; Vendimi i Apelit të Veselit, para. 51-53.

[9] KSC-BC-2020-06, F00509, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Urdhër të Përshpejtuar me Shtojcën 1,* 7 tetor 2021, publike, me një shtojcë, F00509/A01, publike.

PUBLIC
Date original: 08/10/2021 17:12:00
Date translation: 13/10/2021 14:22:00

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në pajtim me nenin 39(13) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, kur është e nevojshme, me kërkesë të palës apo mbrojtësit të viktimave ose me nismën e vet, mund të nxjerrë çfarëdo urdhri tjetër që mund të jetë i nevojshëm për përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor të drejtë dhe të shpejtë.

7. Në pajtim me nenin 53(1) të Ligjit, duke mbajtur parasysh të drejtat e të akuzuarit të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit, të gjitha subjektet dhe personat në Kosovë bashkëpunojnë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe pa vonesë respektojnë çdo kërkesë për asistencë ose urdhrat apo vendimet e dhëna nga Dhomat e Specializuara apo Zyra e Prokurorit të Specializuar.

III. DISKUTIM

8. Duke mbajtur parasysh kushtet e propozuara nga të akuzuarit në lidhje me kërkesat e tyre për lirim të përkohshëm dhe pa cenuar asnjë vendim që mund të marrë Gjykatësi i Procedurës Paraprake në lidhje me vendimet e kthyera për rishikim nga Gjykata e Apelit,[10] Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron

[10] KSC-BC-2020-06, F00122, Mbrojtësja e Specializuar, *Kërkesë për Lirim të Përkohshëm, me Shtojcat Konfidenciale 1-2 dhe Shtojcën Publike 3,* 7 dhjetor 2020, konfidenciale, para. 19, 35, 48 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 18 dhjetor 2020, F00122/RED); F00124, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes për Lirim të Përkohshëm,* 7 dhjetor 2020, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u lëshua më 12 dhjetor 2020, F00124/RED), para. 48; F00151, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë për Lirim të Përkohshëm të Kadri Veselit, me Shtojcat 1 deri në 7,* 17 dhjetor 2020, publike, para. 10; F00329, Mbrojtësja e Specializuar, *Parashtrime të Mbrojtjes së Krasniqit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 31 maj 2021, konfidenciale, para. 48-49 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 qershor 2021, F00329/RED); F00341, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime të Mbrojtjes së Veselit mbi Rishikimin e Paraburgimit, me Shtojcat Konfidenciale A deri në C,* 4 qershor 2021, konfidenciale, para. 36 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 25 qershor 2021, F00341/RED); F00358/A01, Mbrojtësja e Specializuar, *Shtojca 1 e Kundërpërgjigjes së Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë lidhur me Parashtrimet e Mbrojtjes mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 18 qershor 2021, konfidenciale, f. 3-4; F00361, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Përgjigjes së ZPS-së lidhur me Parashtrimet e Mbrojtjes mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 18 qershor 2021, konfidenciale, para. 18-21 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 30 qershor 2021, F00361/RED); F00361/A01, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 1 e Kundërpërgjigjes së Mbrojtjes së Selimit ndaj Përgjigjes së*

PUBLIC
Date original: 08/10/2021 17:12:00
Date translation: 13/10/2021 14:22:00

Policinë e Kosovës të dorëzojë, siç përcaktohet më tej në Shtojcën e këtij Urdhri, informacion në lidhje me: (i) autoritetin dhe kapacitetin e Policisë së Kosovës për të kufizuar lëvizjet e individëve subjekte të lirimit me kusht, për të monitoruar dhe kufizuar komunikimet e këtyre individëve, për të administruar arrest shtëpiak si dhe zbatueshmërinë e kushteve që shoqërojnë lirimin e përkohshëm; dhe (ii) raste të mëparshme të zbatimit të kushteve që shoqërojnë lirimin me kusht ose paraburgimin e personave të akuzuar për krime të rënda. Krahas kësaj, Policia e Kosovës mund të dorëzojë çdo informacion tjetër shtesë që e konsideron se ka lidhje me sigurimin e zbatimit të lirimit me kusht.

9. Policia e Kosovës të ndërlidhet me departamente dhe/ose autoritete të tjera të Kosovës në qoftë se është e nevojshme për dhënien e informacionit të kërkuar. Çdo pengesë teknike, logjistike ose e një natyre tjetër që pengon zbatimin e duhur të këtij Urdhri i duhet bërë menjëherë e ditur Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

ZPS-së lidhur me Parashtrimet e Mbrojtjes mbi Rishikimin e Paraburgimit, 18 qershor 2021, konfidenciale, f. 6-8.

PUBLIC
Date original: 08/10/2021 17:12:00
Date translation: 13/10/2021 14:22:00

IV. VENDIM

10. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

(a) **URDHËRON** Policinë e Kosovës që, në bashkëpunim me departamente dhe/ose autoritete të tjera të Kosovës në qoftë se është e nevojshme, të dorëzojë informacionin e përcaktuar në Shtojcën e këtij Urdhri brenda dy javësh pas njoftimit të përkthimit në gjuhën shqipe të këtij Urdhri (përfshirë Shtojcën e tij);

(b) **URDHËRON** Policinë e Kosovës të respektojë konfidencialitetin e Shtojcës dhe të përmbajtjes së saj;

(c) **URDHËRON** Njësinë e Përkthimit t'i përkthejë këtë Urdhër dhe Shtojcën e tij në gjuhën shqipe deri jo më vonë se dita **e mërkurë, 13 tetor 2021**; dhe

(d) **URDHËRON** Administratoren t'ia transmetojë menjëherë këtë Urdhër dhe Shtojcën e tij Policisë së Kosovës dhe të transmetojë përkthimin në gjuhën shqipe të tyre sapo të jetë i gatshëm.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E premte, 8 tetor 2021

Hagë, Holandë.